



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

URDHËR

Nr. 672, datë 22.4.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË LARTË DISIPLINOR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 13, pika 2, shkronja “f” të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 9, pika 5, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit të Lartë Disiplinor” dhe lidhjeve përkatëse, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Me këtë rregullore të njihet i gjithë personeli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
3. Përgjigjen për zbatimin e kësaj rregulloreje ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
4. Ndjekin zbatimin e kësaj rregulloreje Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Komandantët e Forcave dhe Strukturave Mbështetëse.
5. Rregullorja “Për organizimin, përbërjen, funksionimin e komisionit disiplinor dhe procedurat për dhënien, ekzekutimin e administrimin e masave disiplinore për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” e miratuar me urdhrin nr. 398, datë 14.06.2004 të Ministrit të Mbrojtjes, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIMI KODHELI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES**

RREGULLORE

**“PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN
DHE PËRBËRJEN E
KOMISIONIT TË LARTË DISIPLINOR”**

Miratuar me Urdhrin nr. ____ datë __.__.2015 të Ministrit të Mbrojtjes

PËRMBAJTJA

Kreu I: Dispozita të përgjithshme

- Neni 1: Baza ligjore
- Neni 2: Objekti
- Neni 3: Qëllimi
- Neni 4: Subjektet
- Neni 5: Juridiksioni territorial
- Neni 6: Autoriteti për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor

Kreu II: Organizimi dhe përbërja e Komisionit të Lartë Disiplinor

- Neni 7: Organizimi
- Neni 8: Përbërja e Komisionit të Lartë Disiplinor
- Neni 9: Rastet e papajtueshmërisë
- Neni 10: Urdhri për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor
- Neni 11: Oficeri disiplinor
- Neni 12: Dokumentacioni dhe veprimet procedurale
- Neni 13: Marrja e deklarimeve nga oficeri disiplinor
- Neni 14: Mbrojtja

Kreu III: Funksionimi i Komisionit të Lartë Disiplinor

- Neni 15: Funksionet e Komisionit të Lartë Disiplinor
- Neni 16: Procedura e Komisionit të Lartë Disiplinor
- Neni 17: Mungesa e ushtarakut të proceduar ose e mbrojtësit të tij
- Neni 18: Thirrja dhe pyetja e dëshmitarëve gjatë seancës
- Neni 19: Shtyrja e afatit të shqyrtimit disiplinor
- Neni 20: Marrja e vendimit nga Komisioni i Lartë Disiplinor
- Neni 21: Zbatimi i rregullores

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit të Lartë Disiplinor”, bazohet në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është organizimi, përbërja dhe funksionimi i Komisionit të Lartë Disiplinor, si dhe përcaktimi i veprimeve procedurale për shqyrtimin e procedimit disiplinor dhe dhënien e masave për shkeljet shumë të rënda disiplinore të përcaktuara në nenin 13, të kreu II, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 3 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin juridik dhe përcaktimin e veprimeve procedurale për dhënien e masës disiplinore ndaj ushtarakut të akuzuar për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore, duke garantuar të drejtën e ushtarakut për t’u informuar dhe për t’u mbrojtur ndaj akuzës për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore.

Neni 4 Subjektet

Subjekt i kësaj rregulloreje janë ushtarakët aktiv të Forcave të Armatosura, kursantët, si dhe ushtarakët në rezervë kur janë në shërbim ushtarak për stërvitje ose shërbim gjatë një mobilizimi ushtarak të cilët akuzohen për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore.

Neni 5 Juridiksioni territorial

Kjo rregullore është e zbatueshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë territorit të saj për ushtarakët shqiptarë kur ata janë dërguar me mision, shërbim, stërvitje të përbashkët, mision diplomatik ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumë palëshe.

Neni 6
Autoriteti për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor

Në kuptim të kësaj rregulloreje, autoritetit përgjegjës, për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor është Ministri i Mbrojtjes ose Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

KREU II
ORGANIZIMI DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT TË LARTË DISPLINOR

Neni 7
Organizimi

1. Komisioni i Lartë Disiplinor organizohet dhe funksionon në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
2. Komisioni ngrihet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes për shqyrtimin e procedimeve disiplinore për shkelje shumë të rënda disiplinore, të kryera nga oficerët e Forcave të Armatosura.
3. Komisioni ngrihet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për shqyrtimin e procedimeve disiplinore për shkelje shumë të rënda disiplinore, të kryera nga nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura.
4. Urdhri për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor nënshkruhet brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të raportimit në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes ose të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
5. Ky urdhër i dërgohet për njohje ushtarakut që do të procedohet disiplinarisht brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit të tij.

Neni 8
Përbërja e Komisionit të Lartë Disiplinor

1. Komisioni i Lartë Disiplinor ka në përbërje jo më pak se 5 oficerë me grada më të larta ose të njëjta me ato të ushtarakut ndaj të cilit do të procedohet disiplinarisht.
2. Komisioni i Lartë Disiplinor për shqyrtimin e shkeljeve shumë të rënda disiplinore të kryera nga ushtarakë me grada më të larta kryesohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, përveç rastit kur procedohet ky i fundit, si dhe rastit kur Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA është në kushtet e papajtueshmërisë sipas shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “e”, të pikës 1, të nenit 9, të kësaj rregulloreje.
3. Komisioni i Lartë Disiplinor në rastin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ka në përbërje jo më pak se tre oficerë me grada më të larta.

4. Kryetari i Komisionit të Lartë Disiplinor caktohet një oficer me gradë jo më të ulët se gradat e anëtarëve të komisionit, e ushtarakut që ka kryer shkeljen dhe e mbrojtësit të tij, përveç rastit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni.
5. Numri i anëtarëve të Komisionit të Lartë Disiplinor duhet të jetë gjithmonë një numër tek.
6. Anëtar i Komisionit të Lartë Disiplinor mund të caktohet çdo oficer i Forcave të Armatosura.

Neni 9 **Rastet e papajtueshmërisë**

1. Nuk mund të jetë pjesë e Komisionit të Lartë Disiplinor ose oficer disiplinor:
 - a. eprori ose vartësi i drejtpërdrejtë i ushtarakut që procedohet për shkelje shumë të rëndë disiplinore, përveç rastit kur procedohet Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA;
 - b. ushtaraku që ka bërë raportimin e shkeljes disiplinore shumë të rëndë;
 - c. ushtaraku që ka informuar, konstatuar apo që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga shkelja disiplinore;
 - ç. ushtaraku që ka lidhje familjare/gjaku deri në shkallën e tretë, apo bashkëjeton me ushtarakun që procedohet për shkeljen disiplinore;
 - d. ushtaraku që ka qenë oficer disiplinor në shqyrtimin e një shkelje disiplinore të mëparshme të të njëjtit ushtarak brenda një harku kohor prej 12 muajsh;
 - dh. ushtaraku i pa rehabilituar sipas nenit 23, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
 - e. ushtaraku që vetë ose pjesëtarët e familjes së tij kanë interesa ekonomike e financiare të përbashkëta me ushtarakun që procedohet për shkeljen shumë të rëndë disiplinore;
 - ë. ushtarakët që frekuentojnë kurset institucionale.
2. Ushtaraku që ankohet ka të drejtë që të kërkojë papajtueshmërinë e krijuar me kryetarin/anëtarin e Komisionit të Lartë Disiplinor dhe/ose oficerin disiplinor, tek autoriteti përgjegjës për ngritjen e komisionit. Kërkesa duhet të jetë e motivuar.
3. Formati i kërkesës përcaktohet në formularin KLD Model-1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
4. Kryetari/anëtarin e Komisionit të Lartë Disiplinor dhe/ose oficerin disiplinor kur konstaton se ka papajtueshmëri i paraqet dorëheqjen autoritetit përgjegjës për ngritjen e komisionit.
5. Nëse verifikohet papajtueshmëria, autoriteti përgjegjës merr masa të menjëhershme për zëvendësimin e kryetarit/anëtarit të Komisionit të Lartë Disiplinor dhe/ose oficerit disiplinor.

Neni 10 **Urdhri për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor**

1. Urdhri i autoritetit përgjegjës për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor, duhet të përmbajë:

- a. emërtimin e urdhrimit me emrin dhe mbiemrin e ushtarakut që do të procedohet për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore;
 - b. shkeljen shumë të rëndë disiplinore që do të bëhet objekt shqyrtimi;
 - c. përbërjen nominale dhe funksionale të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të Lartë Disiplinor;
 - ç. kohën e fillimit dhe përfundimit të procedurës së shqyrtimit të shkeljes disiplinore. Kjo kohë nuk duhet të jetë më shumë se 25 ditë kalendarike nga data e njohjes së ushtarakut që do të procedohet disiplinarisht me urdhrin për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor;
 - d. oficerin disiplinor që do të kryejë hetimin për shkeljen shumë të rëndë disiplinore;
 - dh. sekretarin e komisionit, i cili mban procesverbalin e seancave.
2. Format i urdhrimit përcaktohet në formularin KLD Model-2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.

Neni 11 Oficeri disiplinor

1. Oficeri disiplinor përfaqëson akuzën në procesin disiplinor dhe kryen hetimin e shkeljes shumë të rëndë disiplinore. Hetimi shërben për të verifikuar shkeljen shumë të rëndë disiplinore.
2. Oficeri disiplinor duhet të jetë oficer me gradë të lartë.
3. Oficeri disiplinor fillon hetimin disiplinor nga data e daljes së urdhrimit për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor dhe zhvillon hetimin brenda një harku kohor prej 20 ditësh kalendarike.

Neni 12 Dokumentacioni dhe veprimet procedurale

1. Oficeri disiplinor gjatë hetimit disiplinor kryen këto procedura:
 - a. i dorëzon ushtarakut që procedohet, me procesverbal njohjeje, një kopje të urdhrimit për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor;
 - b. njihet me dokumentacionin e praktikës të konstatimit të shkeljes shumë të rëndë disiplinore;
 - c. kryhen hetime, merr dëshmi dhe mbledh dokumentacion shtesë që i shërben hetimit;
 - ç. fton ushtarakun ndaj të cilit kryhet hetimi dhe/ose mbrojtësin e tij që të studiojë aktet dhe dokumentet që janë mbledhur kundrejt tij, duke e informuar për të drejtën e njohjes, mbajtjes së shënimeve dhe marrjen e kopjeve të këtij dokumentacioni;
 - d. fton ushtarakun ndaj të cilit kryhet hetimi dhe/ose mbrojtësin e tij të sjellë pretendime dhe dokumentacione të tjera në lidhje me shkeljen për të cilën procedohet disiplinarisht, të përcaktojë ku dhe/ose ndaj kujt dëshiron që të kryhen verifikime dhe hetime të tjera ose të merren dëshmi;
 - dh. kryhen verifikimet dhe hetimet e mëtejshme të kërkuara nga ushtaraku ndaj të cilit procedohet disiplinarisht;

- e. përgatit relacionin përmbyllës me përfundimet e nxjerra dhe formulon propozimet e tij për masën disiplinore shumë të rëndë;
 - ë. fton sërish ushtarakun ndaj të cilit procedohet disiplinarisht dhe/ose mbrojtësin e tij të njihet me aktet dhe relacionin përmbyllës si dhe të marrë kopje të tyre;
 - f. inventarizon të gjitha aktet e hetimit disiplinor që duhet të jenë të numëruara, përfshi dhe relacionin përmbyllës, që do ta nënshkruajë duke i vendosur datën.
2. Oficeri disiplinor krijon fashikullin hetimor disiplinor i cili ka në përbërje:
 - a. kopje të praktikës së dokumentacionit të konstatimit dhe raportimit të shkeljes disiplinore shumë të rëndë;
 - b. dokumentet e kërkuara ose ato që mendohet se janë të nevojshme;
 - c. gjithë dokumentacionet dhe aktet e mbledhura gjatë hetimit disiplinor;
 - ç. relacioni përmbyllës për hetimin disiplinor;
 - d. procesverbalin e njohjes me aktet e mbledhura gjatë hetimit disiplinor.
 3. Format i procesverbalit të njohjes përcaktohet në formularin KLD Model-3, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.

Neni 13

Marrja e deklarimeve nga oficeri disiplinor

1. Thirrja e ushtarakëve që kanë dijeni për shkeljen shumë të rëndë disiplinore bëhet sipas formularit KLD Model-4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
2. Para se të deklarojë, ushtaraku që ka dijeni i bëhet e ditur se, në rast se deklaron të dhëna të rreme, ai do të përgjigjet disiplinarisht për shkelje disiplinore të parashikuar nga shkronja “r”, e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
3. Dëshmitari kur thirret, sipas pikës 3, të këtij neni, është i detyruar të paraqitet. Nëse mos paraqitja dhe mungesa e tij nuk është e shkaktuar nga forca madhore, mosmarrja e njoftimit ose ndonjë pengesë tjetër të vlerësuar nga oficeri disiplinor që e përjashton nga përgjegjësia, përbën shkelje disiplinore e parashikuar nga shkronja “rr”, e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
4. Deklarata merret sipas formularit KLD Model-5, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.

Neni 14

Mbrojtja

1. Ushtaraku i proceduar për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore, pas njohjes me urdhrin për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor, deklaron tek oficeri disiplinor, mbrojtjen gjatë procesit disiplinor nëpërmjet një oficeri mbrojtës apo nga vetë ai.

2. Formati i deklarimit përcaktohet në formularin KLD Model-6, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj. Ky formular i vihet në dispozicion ushtarakut në procedim nga oficeri disiplinor dhe nënshkruhet nga deklaruesi dhe mbrojtësi.
3. Ushtarak mbrojtës mund të zgjidhet çdo ushtarak i shërbimit aktiv.
4. Ushtaraku mbrojtës në rast se pranon detyrën duhet të mbulojë gjithë procesin disiplinor.
5. Ushtaraku mbrojtës nuk mund të kërkojë zëvendësimin apo mos të pranojë detyrën pasi e ka pranuar njëherë, përveç rasteve të veçanta që nuk lejojnë vazhdimin e detyrës, ose kur kërkohet shprehimisht nga ushtaraku që procedohet për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore.
6. Nëse ushtaraku që procedohet nuk ka mundësi të zgjedhë një ushtarak mbrojtës, por dëshiron të përfaqësohet me një të tillë, bën kërkesë dhe mbrojtësi i caktohet menjëherë me urdhër nga autoriteti përgjegjës për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor. Ushtaraku i caktuar duhet të ketë profilin jurist dhe nuk mund të refuzojë detyrën.
7. Formati i kërkesës përcaktohet në formularin KLD Model-7, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
8. Nuk mund t'i caktohet detyra e mbrojtësit ushtarakut që ka konstatuar shkeljen apo që është prekur drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë nga shkelja.
9. Ushtaraku mbrojtës në rast se është e nevojshme hiqet nga detyrimet e tjera të shërbimit që ai ka.
10. Një ushtarak nuk mund të ushtrojë për më shumë se 6 herë detyrën e ushtarakut mbrojtës në 12 muaj.

KREU III

FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË LARTË DISIPLINOR

Neni 15

Funksionet e Komisionit të Lartë Disiplinor

Komisioni i Lartë Disiplinor është përgjegjës për shqyrtimin e shkeljeve shumë të rënda disiplinore dhe marrjen e vendimit për dhënien ose jo të masës disiplinore.

Neni 16

Procedura e Komisionit të Lartë Disiplinor

1. Hapja e seancës, bëhet nga kryetari i komisionit duke ndjekur këtë procedurë:
 - a. hapet seancën e shqyrtimit të shkeljes shumë të rëndë disiplinore;
 - b. verifikohet prania e anëtarëve dhe sekretarit të komisionit, oficerit disiplinor, ushtarakut që procedohet dhe mbrojtësit të tij, nëse ka një të tillë;

- c. merren gjeneralitetet e ushtarakut që procedohet, oficerit disiplinor dhe oficerit mbrojtës, nëse ka një të tillë;
 - ç. sigurohet paraqitja dhe shqyrtimi i paanshëm i provave dhe fakteve që sjellin palët, për të vërtetuar fajësinë apo pafajësinë e ushtarakut që procedohet;
 - d. i kujtohet ushtarakut e drejta që ka për t'u mbrojtur vetë apo me anë të oficerit mbrojtës;
 - dh. i kujtohet ushtarakut e drejta për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve të komisionit apo oficerit disiplinor nga procesi, kur gjykon se ekziston një nga rastet e nenit 9 dhe 14 të kësaj rregulloreje;
 - e. i kujtohet ushtarakut e drejta për të mos dhënë përgjigje për pyetjet që i drejtohen.
2. Procedura e zhvillimit të seancës disiplinore.
 - a. parashtrimi, nga kryetari i komisionit, i objektit të shqyrtimit nga komisioni;
 - b. parashtrimi, nga oficeri disiplinor, i pretendimeve, i provave dhe fakteve ku është mbështetur akuza e ngritur si dhe kërkesa e tij në lidhje me objektin e gjyqimit;
 - c. parashtrimi i nga ushtaraku që procedohet ose mbrojtësi i tij, i provave dhe fakteve ku mbështeten pretendimet e tij në lidhje me objektin e gjyqimit;
 - ç. dëgjimi i dëshmitarëve dhe paraqitja e dokumenteve.
 3. Gjatë seancës kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë të drejtë t'i drejtojnë pyetje ushtarakut që procedohet ose mbrojtësit të tij, oficerit disiplinor dhe dëshmitarëve. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe palët kundrejt njëra tjetrës dhe dëshmitarëve.
 4. Të gjitha zhvillimet gjatë seancës regjistrohen në procesverbal të mbajtur nga sekretari i komisionit. Procesverbali nënshkruhet nga pjesëmarrësit në seancë.

Neni 17

Mungesa e ushtarakut të proceduar ose e mbrojtësit të tij

1. Kur ushtarakut i akuzuar nuk paraqitet në seancë dhe mungesa e tij është e shkaktuar nga forca madhore, mosmarrja e njoftimit ose ndonjë pengesë tjetër të vlerësuar nga komisioni që e përjashton nga përgjegjësia, Komisioni i Lartë Disiplinor, edhe kryesisht, shtyn shqyrtimin disiplinor, duke caktuar datën dhe orën e seancës së re.
2. Komisioni i Lartë Disiplinor vendos sipas pikës 1, të këtij neni, kur mungon mbrojtësi i zgjedhur nga ushtaraku ndaj të cilit është dhënë masa disiplinore dhe nuk ekziston mundësia e zëvendësimit të tij, përveç rasteve kur ushtaraku që procedohet kërkon të vazhdojë procedimi edhe në mungesë të mbrojtësit.
3. Kur ushtaraku që procedohet nuk paraqitet në seancë pa patur shkaqe të ligjshme, largohet nga seanca, apo jep pëlqimin që procesi disiplinor të zhvillohet në mungesë, ai përfaqësohet nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij dhe nëse nuk ka të tillë apo ky i fundit nuk paraqitet pa patur shkaqe të ligjshme, procesi zhvillohet në mungesë.

Neni 18

Thirrja dhe pyetja e dëshmitarëve gjatë seancës

1. Dëshmitarët thirren nga Komisioni i Lartë Disiplinor, kur kërkohet nga ushtaraku që procedohet, mbrojtësi i tij dhe/ose oficeri disiplinor.
2. Thirren si dëshmitarë vetëm personat që kanë qenë prezent në shkeljen disiplinore shumë të rëndë ose kanë dijeni për këtë shkelje.
3. Dëshmitarët pyeten veç e veç dhe vetëm për faktet që kanë lidhje me shkeljen disiplinore shumë të rëndë që shqyrtohet.
4. Dëshmuari nuk mund të dëshmojë për çka flitet në publik, të shprehë qëndrime personale apo të dëshmojë për qëndrim moral të ushtarakut që procedohet.
5. Pyetja e dëshmitarëve bëhet fillimisht nga oficeri disiplinor, nga ushtaraku që procedohet ose oficeri mbrojtës që ka kërkuar pyetjen. Më pas pyetja vazhdon nga pala tjetër.
6. Dëshmitarit nuk i bëhen pyetje që ndikojnë në paanësinë e tij ose që synojnë sugjerim të përgjigjeve.
7. Para se të dëshmojë, dëshmitarit i bëhet e ditur se, në rast se dëshmon të dhëna të rreme, ai do të përgjigjet disiplinarisht për shkelje disiplinore të parashikuar nga shkronja “r”, e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
8. Dëshmitari kur thirret, sipas pikës 1 të këtij neni, është i detyruar të paraqitet. Nëse mos paraqitja në seancë dhe mungesa e tij nuk është e shkaktuar nga forca madhore, mosmarrja e njoftimit ose ndonjë pengesë tjetër të vlerësuar nga komisioni që e përjashton nga përgjegjësia, përbën shkelje disiplinore e parashikuar nga shkronja “r”, e pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 19

Shtyrja e afatit të shqyrtimit disiplinor

Afati i shqyrtimit disiplinor mund të shtyhet për arsye madhore për aq kohë sa zgjat shkakun dhe bëhet nga autoriteti përgjegjës që ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor.

Neni 20

Marrja e vendimit nga Komisioni i Lartë Disiplinor

1. Vendimi në Komisionin e Lartë Disiplinor merret pa prezencën e personave të tjerë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.
2. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i bazuar në prova dhe në ligj.
3. Vendimi i Komisionit të Lartë Disiplinor përmban:
 - a. përbërjen e Komisionit të Lartë Disiplinor që ka dhënë vendimin;

- b. gjeneralitetet e ushtarakut të shqyrtuar nga komisioni ose të dhëna të tjera që vlejné për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e mbrojtësit dhe oficerit disiplinor;
 - c. shkeljen shumë të rëndë disiplinore që është shqyrtuar;
 - ç. parashtrimin e përmbledhur të rrethanave, fakteve dhe provave mbi të cilat është bazuar vendimi;
 - d. shpalljen fajtor ose jo të ushtarakut të proceduar për shkeljen shumë të rëndë disiplinore dhe masën shumë të rëndë disiplinore përkatëse në rast të shpalljes fajtor, rrethanat lehtësuese ose rënduese të cilat kanë ndikuar në caktimin e kësaj mase;
 - dh. datën dhe nënshkrimin e anëtarëve të komisionit.
4. Formati vendimit përcaktohet në formularin KLD Model-8, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe pjesë e pandarë e saj.
 5. Zbardhja e vendimit të marrë nga Komisioni i Lartë Disiplinor bëhet brenda 2 ditësh nga përfundimi i procesit disiplinor.
 6. Autoriteti përgjegjës brenda 3 ditësh nga dita e zbardhjes së vendimit të Komisionit të Lartë Disiplinor, nxjerr urdhër për zbatimin e këtij vendimi.
 7. Në rastin kur ushtaraku i proceduar është një oficer me gradë madhore, afati i autoritetit përgjegjës për nxjerrjen e urdhrit ose dekretit është 15 ditë pas zbardhjes së vendimit të Komisionit të Lartë Disiplinor.
 8. Urdhri ose dekreti i komunikohet me shkrim ushtarakut që procedohet brenda 48 orëve.

Neni 21

Zbatimi i rregullores

1. Ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura janë të detyruar të zbatojë me përpikmëri dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje nga ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masave përkatëse disiplinore, sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

KËRKESË

PËR

PËRJASHTIM ANËTARI OSE OFICERI DISIPLINOR

Nr.____ Prot.,

____.____.____

Datë

Kërkuesi: _____ (gradë, emër, mbiemër)

Drejtuar: _____ (Ministrit të Mbrojtjes/Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA)

I nderuar _____,

Në bazë të nenit 9, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit të Lartë Disiplinor”, kërkoj përjashtimin e _____ (gradë, emër, mbiemër), i cili është (kryetar/anëtar/oficer disiplinor), në Komisionin e Lartë Disiplinor të ngritur ndaj personit tim, për shkak se _____ (arsyeja e papajtueshmërisë)

KËRKUESI

(gradë, emër, mbiemër, firmë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
(Ministri / SHSHPFA)

URDHËR

Nr. _____ Datë ____ . ____ . ____

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT TË LART DISIPLINOR PËR SHQYRTIMIN E
SHKELJES SHUMË TË RËNDË DISIPLINORE NË NGARKIM TË**
(gradë, emër, mbiemër)

Në mbështetje të _____ *(Për MM - nenit 13, pika 2, shkronja "f", / Për SHSHPFA - nenit 15, pika 9, shkronja "sh")*, _____ të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 9, të ligjit nr. 173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të RSH",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Lart Disiplinor për shqyrtimin e shkeljes shumë të rëndë disiplinore _____, të përcaktuar në nenin 13, shkronja _____, të ligjit nr. 173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", në ngarkim të _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion)* _____.

2. Komisioni të përbëhet nga:

1. _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion)* _____, Kryetar
2. _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion)* _____, Anëtar
3. _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion)* _____, Anëtar
4. _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion)* _____, Anëtar
5. _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion)* _____, Anëtar

3. _____ (*gradë, emër, mbiemër, funksion*), caktohet oficer disiplinor.
4. _____ (*gradë, emër, mbiemër, funksion*), caktohet sekretar i Komisionit të Lart Disiplinor.
5. Komisioni i Lartë Disiplinor të nisë procedurën e shqyrtimit të shkeljes shumë të rëndë disiplinore me datë __.__.____ dhe të marrë vendim brenda datës __.__.____.
6. Komisioni i Lart Disiplinor të zhvillojë mbledhjet në _____ (*vendi ku do të zhvillohen mbledhjet*), në Shtabin e Përgjithshëm të FA.
7. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri Kryetari i Komisionit të Lart Disiplinor.
8. Ndjek zbatimin e këtij urdhri Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

(MINISTRI / SHSHPFA)

(emër, mbiemër, firmë / grada, emër, mbiemër, firmë)

PROÇESVERBAL

I NJOHJES ME AKTET

Nr. _____, Prot.

Datë, _____.____._____

Sot, me datë _____.____._____ në _____ *(vendi ku mbahet procesverbali)* _____, ora _____, në bazë të nenit 12, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit të Lartë Disiplinor”, mbahet ky procesverbal për njohjen e _____ *(gradë, emër, mbiemër, i ushtarakut në procedim)* me aktet e mbledhura gjatë hetimit disiplinor në lidhje me procedimin disiplinor të nisur në ngarkim të tij.

_____ *(gradë, emër, mbiemër i ankuesit)* iu vunë në dispozicion aktet si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Ushtaraku në procedim

Oficeri Disiplinor

(grada, emër, mbiemër, nënshkrimi)

(grada, emër, mbiemër, nënshkrimi)

Shënim: Një kopje e këtij procesverbali, pasi protokollohet, i jepet ankuesit.

FLETËNJOFTIM PËR MARRJE DEKLARIMESH

Nr _____ Prot.

Datë _____.____._____

Drejtuar: _____
(grada, emri, mbiemri)

Me adresë: _____
(adresa e plotë e punës, vendbanimit apo vendqëndrimit)
_____.

Bazuar në nenin 13, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit të Lart Disiplinor”, njoftoheni për t’u paraqitur më datë _____.____._____, ora _____, në _____
(vendi ku do të merret deklarata) _____, tek _____
(gradë, emër, mbiemër i oficerit disiplinor) _____ me numër zyre _____ dhe celulari _____.

Njoftimi për paraqitje bëhet pasi do të intervistoheni (deklaroni) lidhur me : _____
(Përshkruhet shkurtimisht arsyeja e paraqitjes)

_____.

OFICERI DISIPLINOR

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Data e dorëzimit _____.____._____.

Dorëzuesi i fletënjoftimit

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Marrësi i fletënjoftimit

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Fletënjoftimi pasi nënshkruhet, i kthehet oficerit disiplinor personalisht nga marrësi.

DEKLARIM PËR ZGJEDHJEN E MBROJTËSIT

Nr. _____ **Prot.**

Datë ____ . ____ . ____

Unë i nënshkruari _____ (*gradë, emër, mbiemër*), efektivi i _____ (*struktura ku shërben*), mbështetur në nenin 14, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit të Lart Disiplinor”, deklaroj se zgjedh si mbrojtës në çështjen disiplinore në ngarkimin tim _____ (*gradë, emër, mbiemër i mbrojtësit*), efektivi i _____ (*struktura ku shërben mbrojtësi*).

DEKLARUESI

MBROJTËSI

(*gradë, emër, mbiemër, firmë*)

(*gradë, emër, mbiemër, firmë*)

Shënim: Një kopje e kësaj deklarate, pasi protokollohet, i jepet oficeri disiplinor.

KËRKËSË PËR CAKTIM MBROJTËSI

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ . ____

Drejtuar: _____ *(Ministrit të Mbrojtjes/SHSHPFA)*

Unë i nënshkruari _____ *(gradë, emër, mbiemër)*, efektivi i _____ *(struktura ku shërben)*, mbështetur në nenin 14, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit të Lart Disiplinor” dhe në pamundësi të gjetjes së një mbrojtësi, kërkoj caktimin e një mbrojtësi ushtarak, me profil jurist, për të më përfaqësuar në procesin disiplinor në ngarkim të personit tim, të nisur me urdhër nr. _____, datë ____ . ____ . ____ të _____ *(Ministrit të Mbrojtjes/SHSHPFA)*.

Ju faleminderit.

KËRKUESI

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Një kopje e kërkesës, pasi protokollohet, i jepet kërkuarit.

